


# NAIM FRASHËRI



Bagët e Bujqësija  
Lulet e Veres

**Naim Frashëri**

**BAGËTI E BUJQËSIJA  
LULET E VERËS**

**Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja"  
Tiranë, 1998**

*Pergatiti per botim:  
Gaqo Bushaka*

*Redaktore:  
Donika Budo*

*Art.grafik:  
Jolanda Marjanaku*

# BAGETI E BUJQESIJA

## BAGETI E BUJQESIJA

O malet e Shqipërisë! e ju o lisat e gjatë,  
Fushat e gjera me lule, q'u kam nér ment dit' e natë,  
Ju bregore bukuroshe e ju lumënji' e kulluar,  
Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruar!  
Do të këndoja bagëtinë, që mbani ju e ushqeni,  
O t'vëndethit e bekuar, ju mëndjenë ma dëfreni!

Ti, Shqipëri, më ep nderë, më ep emërin Shqipëtar,  
Zemërënë ti ma gatove plot dëshirë dhe me zjarr.

Shqipëri! ó mëma ime! ndonëse jam i mërguar,  
Dashurinë t'ende kurrë, zemëra s'e ka harruar.  
Kur dëgjon zëthin e s'ëmës, qysh e le qengji  
[kopenë,  
Blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë;  
Edhé në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë  
E ta trëmbin, aq s'kthehet, po shkon në mest  
[si shigjetë.

Ashtu dhe zemra ime më le këtu, tek jam, mua,  
Vjen me vrap e me dëshirë aty në viset e tua.

Tek buron ujët e ftohtë, edhe fryn veriu në verë,  
Tek mbin lulja me gas shumë dhe me bukurë e m'erë,  
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtija,  
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam mënt' e mijë;

Atje l'int diell'i qeshur edhe hëna e gjëzuar,  
Fat' i bardh' e mirësija n'atë vënt janë mbluar;  
Nat' atje 'shtë tjatrë natë, edhe dita tjatrë ditë.  
Në pyjet e gjelbëruar, atje rrinë Perënditë.

Mëndje! merr fushat e malet, jashtë, jashtë nga  
[qyteti,  
Nga brenga, nga thashethemet, nga rrëmuja, nga  
[rrëmeti.

Tek këndon thëllëza me gas dhe zogu me dëshirë,  
E qyqeja duke qeshur, bilbili me emblësirë,  
Tek hapetë trëndafili, atje ma ka ënda të jem,  
Bashkë me shpest edhe unë t'ja thérres këngës e  
[t'ja them.

Të shoh kecërit e shqerrat, deshtë, cjeptë, dhëntë,  
[dhitë,  
Qiellin e zbukuruar, dhenë me lul' e me drtitë.  
- Vashë bukurosh' e bariut, që vjen me llërë  
[përveshur,

Me zëmërë të dëfryer e me buzëzë të qeshur,  
Me dy shqerrazë ndër duar të bukura, si dhe vetë,  
Në sythit t'ënt e shoh gazë, që s'e kam gjetur ndë  
[jetë.

Dashi sysk' e me këmborë, q'e ke manar, po të  
[vjen pas  
Dhe qeni me bes' i larmë, të ndjek me dëshir' e  
[me gas;  
Dashç Perëndinë, pa më thua, a mos na pe bagëtinë?  
- I lash' atje pas më të gdhirë...já atje përtej tek  
[vinë!

O! sa bukuri ka tufa, sa gas bije bagëtija!  
Vinë posa mblet' e plotë! i bekoftë Perëndija!  
Në për shesh' e nér bregore, janë përhapurë shqerrat,  
E kacërrit në për rripat, dhe në gjethet e në ferrat;  
Sa me vrap e me gas bredhin, edhe lozin shoku me  
[shok

Aty përhapenë me nxit, aty mblidhenë prapë tok,  
Edhe prapë tufë-tufë, përhapenë duke bredhur,  
Duke ikur me vrap shumë, duke lojtur, duke hedhur,  
Nxitojn' e s'lodhenë kurrë, edhe kur i mer urija,  
Sicili futet në tufë, suletë te mëm'e tija,  
Posa gjen mëmën e dashur, edhe me vrap i hyn në gjii,  
Rri më gjunjë dhe zë sisën, e qumështin e ëmblë pi:  
Pa e ëma me mall shumë, ndo dhi qoftë e ndo dele,  
Bir' e vetëm e merr në gjii, me gas e me përkëdhele.

Sa të mirazë ke dhënë! Zot i math e i vërtetë!  
E ç'nom të hekur vure, për çdo gjë q'është në jetë!

Sa më pëlqen blegërima, zër' i ëmbl'e bagëtisë,  
Qengji edhe kec' i bukur, që rri më gjunj' e pi sisë!  
Përhapurë bagëtija, në për sheshe, në për brinja,  
Nër lajthi e në për dushnja, ndër murrriza, në dëllinja,  
Bijen zilet e këmborët, dhe fyelli e xhuraja,  
Dhe mbleron e gjelbërojnë fusha, male, brigje, majë,  
Edhe gjithë gjë e gjallë, ndjen në zëmrë një dëshirë,  
Një gas t'ëmbël' e të shumë. O! sa bukur e sa mirë!  
Pelën e ndjek mëz' i bukur, lopës i vete viçi pas,  
Dallëndyshja punëtore, bën folënë me të math gas,  
Qgjicë ikën përpara, i bije tufës në ballë,  
Me zëmrë të çelur shumë, vete si trimi me pallë,  
Zoqtë zënë këng' e valle dhe po kërcejn' e këndojnë.  
E në për dega me lule, si engjëllit fluturojnë,  
Larashi ngrihet përpjetë, thua q'i shpije Perëndisë,  
Një lëvdatë të bekuar për gjësim të gjithësisë.

Qielli sa ësht' i kthjellë, e sa është zbukuruar!  
E dielli sa ndrin bukur, mbi lulet e lulëzuar!

Gjithë këto lule ç'janë? që u ngjallë me një herë!  
Ngaha qielli ke zbritur? ver' o e bukura verë!  
Çdo lulezë ka më vet-he, një emër' e një fytyrë,  
Një bukurë, një mirësë, një shtat, nj'erë e një ngjyrë,  
Si dhe çdo dru e çdo pemë, edhe çdo bar e çdo fletë,  
Sa ësht' e bukur faq' e dheut! s'të ze syri gjë të metë,

Gjithë kjo bukuri vallë nga dheu të ketë mbleruar/  
A me të matht të ti Zoti prej parrajs' e ka dërguar?  
...Veç një njeri shoh pa punë dhe të mjer' e të  
[brengosur,

Të këputur, të mejtuar, të grisur e të rreçkosur,  
Lipën i gjori pa shpresë, se atje e pru përtimi,  
S'i ka mbetur gaz në zëmrë, se s'i la vënt hidhërimi;  
Eshtë njeri, si dhe neve, pa ep-i-ni, o të pasur,  
E mos e lini të urët dhe të mjer' e buzë-plasur,  
Se përtim' i zi, q'e pruri të gjorin më këtë ditë,  
Nuk' e dimë vet' e xgjodhi, apo ja dhanë perënditë;  
Edhe për një mizë, kur heq, i vjen keq njeriut të mirë,  
Zëmëra s'thuhetë zëmrë, po të mos keshë mëshirë.

Ah! edh' atje tej mbi udhë, i duket i shkreti varri!  
Rrethuar me lul' e me bar, një të gjori udhëtarë,  
Që ka vdekur i ri shumë, e ka rarë lark shtëpisë,  
Mërguar nga mëm' e motrë, dhe prej gjithë njerëzisë.  
Një zok i helmuar mi varrt, i rri si mëmëzë dh' e qan,  
Ndarë nga të gjithë shokët, edhe zi për të mjerin  
[mban.

Tomor! o mal i bekuar, fron i lartë, që rri zoti  
Pas fesë vjetër që kishin Shqipëtarëtë që moti,  
Dhe ti Mali-Plak i lartë, që me syt e tu ke parë,  
Luftëra të mëdha shumë, e punë, që kanë ngjarë.

O malet e Shqipërisë, që mbani kryet përpjetë,  
Tëmer e frikë përhapni! përpini qiejt' e retë!

Të pa tundurë për jetë jini, pa kur oshëtini,  
Udhëtaritë në zëmrë frikë të madhe i vini;  
Kini shkëmbinj,gërxhe, lisa, lumënja dhe déborë  
[ndë gjji,

Përsiprë lule' e gjethë dhe brënda ergjët e flori:  
E ju fusha bukuroshe, edhe të majm' e pjellore,  
Ju sheshet e lulëzuar ju bregore gjelbërore.  
Q'u fali Zoti të mira, u mba me shumë pekule,  
U dha bar e gjeth e verí,zoq e flutura e lule,  
Zemrën e varfërë t'ime, aty ndër ju e kam mbuluar,  
Jam lark jush i dëshëruar, edhe s'e duronj dot mallë,  
Po s'e di si dua unë do t'i shoh një herë vallë!

Të paskësha vrapn' e veriut, të kisha krahë pëllumbi,  
Nxitimn' e lumi me valë, q'ikën me verik si plumbi,  
E të vinja në gjit't'uaj nj'uujë të ftohtë të pinja,  
Edhe në për ato hije një copë herë të rrinja,  
Syt' e ballit t'i xbavitnje, zemërënë ta dëfrenje,  
Gazë, që paçë një herë, prap' aty ndër ju tá gjenje.  
O popo! kshu pse më vini, përpara syve pa pushim?  
O ditët' e djalërisë! o moj kohëz' e të rit t'im!

O flutura krahë-shkruar! që fluturon në për erë,  
As mer dhe zëmërënë t'ime, me vet-hezë dhe ma

[shpjerë

Nër malet e Shqipërisë, tek kullosën bagëtija,  
Tek i fryn bariu xhurasë, tek më rrinë mënt' e mijë,  
Ku shkon me zile të madhe, ogiqi për mes lajthisë,  
Po zjen e oshëtin mali, ngaha zër' i bagëtisë;

Marrënë vrapn' e nxitojnë, derdhen në gjollë për kripë,  
Dhënët ndër shesh' e ndër brigje, dhitë në shkëmp  
[e në rripë.

Bariu plak krabën në dorë, edhe urdhëron të rinjtë,  
E atá gjithë punojnë, ngriturë më bres përqinjtë:  
Ca bëjnë vathën e shtrungën, ca ngrehin tëndën  
[e stanë,

Kush sjell gjeth, karthij' e shkarpa, sicilido ndih më  
[një anë

Kush përvjel, kush qeth shëleknë, kush mjel dhitë,  
[kush mjel dhëntë,

Njëri mer ushqen këlyshnë, tjatëri përgëzon qëntë;  
Stopani bër' i zi sterrë, shikon bulmetn' e bekuarë,  
Tunt, bën gjalpë, djathë, gjizë, edhe punon pa përtuar;  
Udhëtarvet, gjahëtorvet, q'u bije udha ndër male,  
U ep mish, qumësht, kos, dhallë, ajkë, djathë,  
[bukëvale...

Kec' i mbeturë pa mëmë dhe i vrfër' e i shkretë,  
Mënt mëmënë, që ka mbetur pa bir e pa gaz në jetë.  
Dëgjohet nga mez' i pyllit krism' e sëpatës  
[s'druvarit,  
E sharrësë, që bën lëndë, dhe fyell i shterparit.

Shterpari s'i qaset stanit, po nér pyje bij' e ngrihet,  
Në për majë, nér bregore, rri, këndon, a gdhënt,  
[a shtrihet;

S'i trëmbetë syri kurrë, vetëm ajy dit' e natë,  
Nga ujku e nga kusari s'ka frik' as nga lis i gjatë,  
As nga shkëmbënjt' e nga pylli; as gogolëtë s'e hanë,  
Armëtë ka shok e vëlla, mëm' e motërë xhuranë,  
Miqt' e ti shqerratë janë, kecëritë, dhitë, dhëntë,  
Cjeptë, ziletë, këmborët, deshtë, e më teprë qëntë,  
Që s'flenë, po rrin e ruajnë bagëtinë dhe barinë,  
Kur e shohin, tundin bishtin, dhe me gaz të math

[i vinë:

S'e hanë njerin' e mirë edhe mikn' e udhëtarë,  
Se njohën, po të liknë, egërsirënë, kusarë.  
Vjen nata, e lë në t'errët, del hëna i përhap dritën,  
Vjen mëngjezi, zbardhëllehet, lint diell'i bije ditën;  
Yjtë, hëna, djelli, shënja, lindin e prapë perndoijnë,  
Gjithë ç'lëvrijnë nér qiej, përpara syvet i shkojnë;  
Mblidhen ret' e hapësira, bënetë e zezë sterrë,  
Vetëtimat e gjëmimet nisin, e shiu zë të bjerë,  
Bariu vë gunën më kokë, z'eshkën me herë të parë,  
Ndes shkarpat sakaqherë, a lisnë fyl, dhe bën zjarë;  
Fishkëllen e thërret qentë si cilën me emër veçan,  
Pa kur derdhetë baliku! ujkun e zë edh' e përlan,  
Se bisha, që bie dëmnë, errësir, e mjergull kërkon,  
Papo bariu shum' ahore vë re dhe mba vesh e dëgjon:  
Dhe sokëllin me zë të math, tunden malet

[e shkëmbenjtë,

Gumëzhitin pyjet e veshur; e oshëtijnë përrenjtë!

Esh't' e lehtë dhi e stanit, që kullot gjethin e malit,  
Dhe bij' e fle majë shkëmbit e pi ujëthit e zallit,

Dhi e shtëpis' ësht' e plokshtë, fle në vath' e nënë  
[strehë,

E pi ujët e rrëkesë edhe shtrihet në plehë,  
Esh't' e butëz' edh' e qetë dhe e urtë si manare,  
Nukë është si malsorja, andaj i thonë bravare.

Në pshat, posa zbardhëllëhet, sheh një plakëzë  
[të gjorë,

Ngrihet, hap derën nga-dale e del me kusi në dorë,  
Rri në derëzët të shtrungës, dhe djali duke dremitur  
I ngjet bagëtin' e dalën, i mjel plakëz' e drobitur;  
Plaku le shkopnë më nj'anë e bën gardhin e zë  
[shtekjnë,

Bariu vë tufën përpara, vasha përkëdhel sheleknë,  
Nusja pshi e ndreq shtëpinë, edhe bën bukën e gjellën,  
I shoqi sheh kanë, lopën, viçin, demnë, kalën pelën,  
Mushkën, që ësht' e harbuar, edhe bashkë me gomarë,  
Rahënë të hedhin murë, të hanë bimën e barë;  
Një grua vete në krua, e jatëra zë të tunjtë,  
Një sheh pulat, miskat, rosat dhe tjatëra bën ç'të  
[muntnjë.

Na hyjnë shumë në punë, kafshëtë dhe bagëtija,  
Na i dha në këtë jetë shok' i ndihmës Perëndija;  
Të mos ishte gjë e gjallë, njeriu s'rronte dot në jetë;  
Do të vdiste nga urija, dot' ish lakuriq e shkretë;  
Gjë e gjallë ne vesh, na mbath, dhe na ushqen e na  
[xbavit

Kur shtohet e vete mbarë, jetënë t'ën e përsërit;  
Edhe dheu, që na ep drithë, si do ta kemi punuar,  
Nukë pjell mirë, si duam, po s'e patmë plehëruar.

O shokët e njeriut! Zoti u shtoftë e u bekoftë,  
Dhe shpirti im mik për jetë sindëkur ka qën' u qoftë.

Kafshët edhe bagëtinë, që u ka kaqë nevojë,  
Njeriu duhet t'i shohë, t'i ketë kujdesë, t'i dojë.

Të mos t'i mundojmë kurrë, po si fëmijë t'i kemi,  
Eshtë mëkat edhe fjalë të ligë për to të themi.

Dellëndyshe bukuroshe! që thua mijëra fjalë,  
Dhe të k' ënda vahn e lumën, që vjen me vrap e  
[me valë,

A mos vjen nga Shqipëria? apo vjen prej Çamërije  
Me këto mijëra fjalë e me gjuhë perëndije?  
Apo vjen nga Labërija, pra më duke kaqë trime?  
Edhe fjalëtë që thua, më gëzojnë zëmrën t'ime,  
Q'është thyer, bërë mijë copë, posi një pasqirë,  
Duke këputur nga spangu që s'e kanë vartur mirë;  
Apo vjen nga fush' e Korçës, nga vënd' i mir' e i gjerë,  
Pe zembrësë Shqipërisë, që del gjithë bot' e ndjerë?  
A më vjen pej Malësije, pej Skrapari, pej Dobreje,  
Nga Vijosa, nga Devollli, prej Vlor' e prej Myzeqeje?

Të mundjam të fluturonja e të kishnjam krahë si ti!  
Me gaz të madh dot' i vinjam Shqipërisë brënda  
[në gjil!

Për të marrë drejt Shkumbinë edh' Elbasan'  
[e Tiranën;  
E te ty vinja, Shkodrë, të shoh Drinin e Bujanën!

---

---

Krujënë e Skënder-Beut, q'i ka dhënë nder Shqypris,  
Që luftoi trimërishtë, mundi Mbretin e Turqisë.

Durrës! o qytet' i bukur, që je kërthis' e Mëmëdheut;  
Edhe ti Leshi e emrë! që ke eshtrat' e Skënder-Beut,  
Edhe gjithë Shqipëtarët, t'i mbajë armiku ynë?  
Nukë më ngjan, e s'e besonj kam te Zoti shumë

[shpresë,  
Shqipëria këtej-tutje kshtu po nukë do të mbesë.  
Dua të dal majë malit, të shoh gjithë Arbërinë,  
Vellëzërit Shqipëtarë, që venë në pun' e vinë,  
Burratë trima me besë dhe shpirt-mir' e punëtorë,  
Dhe fushatë gjithë lule e maletë me dëborë.

O fushazëtë pëllore! që m'u shqeni Shqipërinë,  
Do të këndoju bukurinë tuaj edhe bujqësinë.

Ti Perëndi e ligjërisë, që rri në mal të Tomorit,  
Unju pósht' e më ndih pakë, o motra im' e të gjorit!

Më ke leshrat të florinjtë, e të ergjëntë kraharorë,  
Ball e gush e faq' e llërë dhe këmb' e duar dëborë;  
Sindëkur do malësorët dhe pyjet e bagëtinë,  
Duaj edhe fusharakët dhe arat e bujqësinë

Edhe Ti o Mëmëz' e dheut! q'i fale dheut aq' uratë,  
sa pjell mijëra të mira e kurrë s'mbete e thatë!  
I dhe lul' e bar e gjethe, bim' e drith' e pem' e drurë,  
Mblodhe gjithë bukuritë, edhe kanisk ja ke prurë.

Të keqen! o sy-mëshqerë! shikomë një herë në syt:  
Si lulet e si bilbili edhe unë jam djali yt.

...Gjithë këto farë lulesh! e këtë të bukur erë!  
Këtë mblerim! këto ngjyra! vallë nga ç'vënt t'i kesh  
[nxjerë!  
O sa e madhe bukuri! as më thua ku e more!  
O bukuroshe! t'u bëfsha! ngaha gjiri yt e nxore?  
A po me dorë të bukur e more nga gjir' i Zotit?  
Nga qelli? nga parajsa? nga prehër' i plot' motit!

Kudo shkel këmbëza jote, gëzohet vendi e mbleron,  
Tek-do heth sythin e qeshur, bukurij' atje lulëzon!

Ti zbukurón faqen' e dheut, ti do e ushqen njerinë,  
Më të gjallë, dhe pas vdekje e pret duke hapur gjinë!  
Vjen diméri t'i than lulet, ti me një frym' i gjall prap,  
Napënë, q'u hoth përsipër,uá heq me verë, me vapë.

...Bujkun e xgjuan me natë, edhe vë përpara qetë,  
Nisetë pa sbardhëllyer pér punëzë të vërtetë,  
Mer pluarin e parmëndën, zgjedhën, tevlíknë, hostenë,  
Kafshiën, farën, shoknë, bukën, trajstënë, lakrorë,

[qenë...

Shërbëtor' i Mëmës së dheut, q' e ka zëmrën plot  
[shpresë.

Del kur hapet trëndafili, dhe bari' ësht' gjith' vesë,  
I falet Zotit t'vërtetë, dhe zihet nga pun' e mbarë,  
Zemërën e ka të bardhë, dhe të qruar e të larë.

Pa lodhur e pa këputur, pa djersë e pa mundime  
Njeriu i gjorë në jetë nuk gjen dot as thërrime!  
Si të punosh dit' e natë, e të bësh ç'duhen gjithë,  
Ahere kërko nga Zoti, të t'apë bukëz' e drithë.

Njeri! punó, mos psho kurrë, dhe lark nga  
[makutërija.

Zëmërën kije të gjerë, mos ki keq, t'ep Perëndija.  
Puna ka duk e uratë. Zot' i math e ka bekuar,  
Njerinë mi faqe të dheut e dërgoj për të punuar.

Ver' o e bukura verë! që po vjen nga i madhi Zot,  
Me mirësí me bukurí, me gas të math, me duar plot,  
Sindëkur çel trëndafilë, e i fal bilbilit zënë,  
Ashtu na bije nga qjelli një gas në zëmërën t'ënë.

Zot i madh e i vërtetë, për të ushqyer njerinë,  
Për të zbuluar dhenë, për të shtuar mirësinë  
I dha zjar e flakë djellit, i fali dhe shinë resë,  
Bëri dimërin e verën, dhe zemrës s'on' i dha shpresë.

Për të arriturë rushnë ç'ka punuar Perëndija!  
Qielli, dheu, dielli, shiu, njeriu, tërë gjithësija!  
S' është çudi pse na dëfren ver' e bukur zëmrën t'ënë,  
Ç'ka punuar Perëndija edhe njeriu sa e bënë!  
Ju shokë kur pini verën, mos dehi, mos zemërohi,  
Mos u zihni, mos u shani, mos lëvdohi, mos qërtoshi;  
Se pëçmoni Perëndinë, q'i ka falur hardhis rush,  
Edhe kërkon dashurinë e ndodhet pshehtazi ndaj jush;  
Po gëzohi, prehi, qeshni, duhi, sbaviti, dëfreni,  
Flisni fjalë të pëlqyera, loni, këndoni, kërceni,  
Bëjeni zëmërn të gjërë, edhe shtonit dashurinë,  
Mirësinë, njerëzinë, dhe besën e miqësinë;  
Se në breng e në të keqe, në punë e në të pirë,  
Miretë vesh njeriu i lik, njihet njeriu i mirë.

A e shihni gjithësinë? yjtë, diellinë, hënën,  
Dhenë, erën, retë, kohën, kashtën' e kumtërit, shënjën,  
Si janë përveshur gjithë, edhe lëçijn' e punojnë,  
Njëri jatërit i ndiahsin, htu punën e mbarojnë!  
Në mes të këtij rëmeti, të punëtorëve shumë,  
Njeriu duhet të lëçinjë? a po të bjerë në gjumë?

Mundohet punëtori, po në zëmërzët të qetë  
Sa gas të madh ndjen, kur njera, që hodh, i pjell  
[dymbëdhjetë]  
Kur e sheh kaln' e plotë të kërrusurë nga barra,  
Dhe parajsen e vërtetë të çfaqur nëpër ara,  
Kur hedh lëmën e mbledh toknë, ndan bukn' e kashtën  
[më nj'anë]

U hedh kuajvet e qevet, që janë lodhur të hanë  
Kur e përbush plot shtëpinë, me drith' e me gjë  
[të gjallë,

Shtronet me uri në bukë e ha me djersë në ballë.

Sheh pjergullnë, manë, fiknë, thanën, arrën, ullinë,  
Mollën, dardhën, pjeshkën, shegënë, vathënë, ftuan,  
[qershin,

Kumbullatë, zerdelinë ngarkuar në pemë gjithë,  
Oborrë plot gjë të gjallë, shtëpinë mbushur me drithë,  
Dhe zemëra i gëzohet, pa i falet Perëndisë,  
Q'e çpërblen punën e djersën e mundimn' e njerëzisë.

Qysh rroit mblet' e uruar, dhe ven' e vin' e lëcijnë.  
Ca huallinë ndërtojnë, ca nëpër lule shëndijinë,  
O! ç'punë me mënt punojnë! sa bukur e bëjn' e mirë!  
N' apin dyllëtë, q'ep dritë! dhe mjaltë fjesht'  
[jëmbëlsirë!

Dhe punëtorët e mirë m' atë mënyrë punojnë,  
Edhe gjithë njarëzija me mundim t'atyre shkojnë,  
Njëri mihi, tjatëri lëron, njëri mbjell, tjatri prashit,  
Kush than, kush kor, kush mbledh duaj, kush shin,  
[kush sharton, kush krashit'

Një bën pluar' e sëpatën, një parmandën, një shtëpinë,  
Një pret e qep, një mer e ep, një mbath, një shikon  
[mullinë,

Ç'do njeri një farë pune bën në mes të shoqërisë  
Kjo është udh' e Perëndisë, ky ë nom i gjithësisë,  
Edh' ajo miza përdhese, ë' i duhet pér të ngrënë,

Eshtë rrahur e përpjekur, e me kohëz e ka vënë!  
Ka një punë të punojë si ç'do gjë q' është në jetë,  
Kshtu e ka thënë me kohë Zot' i math e i vërtetë.

...Bujku mundohet në verë, po në dimër ri e prëhet,  
Sheh shtëpizënë me kamje, edhe zëmëra i bëhet,  
Gratë të gjitha punojnë n'avlëmënt e në të tjera,  
Edhe jashtë fryn e bije, po kur na trokëllin dera,  
Eshtë nj' udhëtar i gjorë, që ka mbetur në dëborë,  
I kanë ngrirë të mjerit vesh' e goj' e këmbë, e dorë,  
Ngrihet i zot' i shtëpisë, edhe të huajthin e mer,  
E vë në krye të vatrës me njerëzi, me të math nder,  
Posa e shohënë, që vjen, i ngrihen gjithë fëmija;  
Se të huajnë më derë na e dërgon Perëndija,  
Pa i bëjnë zjar, e ngrohet, edh' e mbajnë me të mirë  
I sjellin shtresë të flerë, edhe të ngrën' e të pirë.  
Kështu të huajt e miqtë njeriu, q' është i uruar,  
I pret me krahëror hapur, e i përcjell të gëzuar.

Në verë, që çelen lulet, qelli ndrin si pasqyrë.  
Sbukurohetë faq' e dheut, e mer mijra fytyrë,  
Pa ngjallenë me ç'do lule, më ç'do bar, e më ç'do fletë  
Gjëra të gjalla me mijë, rroitin nga dheu si mbletë.  
Shpest' e mizatë këndojojnë, e kuajtë hingëllijnë,  
Lulet e bukura m' erë si ar e si flori ndrijnë.  
Bujku ngjet pëndën e lëron, mbjell e bën gati ugarë,  
Kalarësi i shkon pranë dhe i thotë-puna mbarë-  
Papo mer anën e lumit, me zëmërë të gëzuar,  
Këndon , fishkëllen, a vete nga-dalë, duke mejtuar,

Vë re lummin e kulluar, që ikën me ligjërimë,  
E ndër mënt të ti i bije ca t'ëmbëla shumë mejtime.  
Vashëzatë bukuroshe, posa shqerratë manare,  
Si kapërrrollet e malit, si thëllëzatë mitare,  
Venë të lajnë në lumë, gjithë tok duke kënduar  
Me gas në sy e në buzë, e me lulezë nér duar,  
Përveshin llérët e bardha dhe të majm' e të përndijta,  
Pulpazëtë bukuroshe, e këmbëzët e kërthijta;  
Dallëndyshja, që fluturon, e ndehetë për mi lumë,  
U afrohet si mike e u thotë fjalë shumë;  
Dhe mëshqer' e përkëdhelur vjen në lumë të pij' ujë,  
A të prehetë në hije, a të bënje gjë rrëmuje.

Bari, bima vatur më bres, e bujku shum' i gëzuar,  
Si bariu kur merr kërthninë edh' e përkëdhel ndër duar.

Bilbili ja thotë bukur, lumi vete gjithë valë,  
Ep erën e Perëndisë trëndafili palë-palë.

Veç një vajz' e mjerë qan të motrënë q' e ka lënë,  
O! është mbuluar në dhe dhe vashëza fytyrë-hënë!  
Mëma dhe motëra mbetur në zi e në vaj të shumë,  
Dhe shqera manarez' e saj e pëzishmez' e për lumë!  
Të këput shpirtinë plaka, kur zë dhe nëmëron e qan,  
Ah! i ziu njeri në jetë sa heq e sa duron e mban!  
Vashën vërtet' e mbuluan, po shpir i saj në qiej  
[shkoi, si o ta bëti]  
Hapi krahëthit e lehtë, në hapësirët fluturoi,  
Bukuri e saj u-përzje me bukurizat e Prillit,

Me fjalëzët e bilbilit, me erët e trëndafilit;  
Gjësendi s'humbetë kurrë, e gjë s'vdes me të  
[vërtetë

Mase ndryshohenë pakë, po janë në këtë jetë,  
As shtohet, as pakësohet, as prishet gjithësija,  
Vdesën e ngjallenë prapë si gjith edhe njerëzija,  
Këtu janë gjithë ç'gjë munt të jetë,  
Engjellitë, Perënditë dhe aqy Zot' i vërtetë!  
Se një trup e një shpirt është gjithësija, që s'ka anë,  
Të gjallë edhe të vdekur, gjithë brenda në të janë.

Perëndija Njerin' e parë e mori prej dore vetë,  
E sbriti mi faqet të dheut, q'ish me lulez' e me fletë.  
Më të drejtënë të themi mbi faqet të dheut e ngriti,  
E bëri të zotthin' e dheut edhe kështu e porositi:

Nga kjo baltë të kam bërë, rri më paç uratë,  
Mos u-loth e mos pusho kurrë, po përpiku dit' e natë,  
Sheh si punon gjithësija! ashtu të punosh edhe ti,  
Të mos rrish kurrë pa punë, e të vesh duar në gji.  
Mos u bëj i lik e i keq, i paudh' e i pabesë.

I rrem, i ndyrë, i dëmshim, i rënduar e pashpresë,  
Mërgohu nga të këqijat, prej vjedhje, prej marrëzije,  
Mos vra, mos merr tek s'ke vënë, edhe ki nom.

[dashurinë,]  
Bes' e fe ki urtësinë; të drejtënë, mirësinë;  
Në bëfsh mirë liksht s'gjën kurrë, po në bëfsh liksht,  
[mos prit mirë.]

Ki dëshirë për të mirë, dhe në zëmërë mëshirë,  
Ji i but' i urt' i vyer, e mos u bëj kurrë makút,  
I egër' e i mërzitur, dhe i mahnitur e hajdut,  
Mos j'u afro dhelpërisë, po së drejtësë j' u-nis pas;  
Në dëgjofsh fjalët e mijë, do të jesh gjithnjë në gas.  
Nga gjithë ç'pat gjithësija të kam dhënë dhe ty pjesë  
Në u-bëfsh, si themi, i mirë, emër' i math do të mbesë  
Të bam dhënë mënt, të mësosh të vërtetën me të ta  
[shohç'

Dhe Zemër' e vetë-dijë, të mir'e të drejtën ta njohç,  
Do të të le dhe nevojën, udhënë të tregojë,  
Të të ndihnj më ç'do punë, të të psonj e të të  
[zgjonjë

Gjithë të mirat që janë këtu në dhet i kam mbuluar,  
Po gjësendi në shesh s'nxjerr dot pa dirsur e pa  
[munduar,

I gjen të gjitha me kohë, po rrëmò thell'e më thellë,  
Ç'do gjë të duhet kërkoje, barku i tij do ta pjellë,  
Sa gjérerazë të vlera do të gjesh ti këtu brenda,  
Edhe përsipërë soje, e sa do të t'i ketë ënda!

Me fuqit, që të kam dhënë, them që të vijnë një ditë,  
Të març udhën e së mirës, e të gjesh të madhe dritë,  
Të març vesh dalë-nga-dalë sa punëra, që kam bërë,  
Diell, hënë, Yje, qiej, e gjithësinë të tërë!

Po që u-bëre i urtë, mua më ke afër teje,  
Ndryshe,- qofsh mallëkuar, edhe mërguarë meje.-

Të parit t'enë Perëndija këto fjalë vetëm i tha,  
I fali gjithë të mirat, i dha uratën dhe e la.

Det i p' an' i mirësisë! q' emrin t'ënt st'a zë dot  
[ngojë!]

Qysh e ngrehe gjithësinë pa lënë fare nevojë!  
Fali njeriut urtësinë, mirësinë, njerëzinë,  
Butësinë, miqësinë, dashuri, vëllazërinë,  
Epu sheshevët lul' e bar, dhe pyjet gjeth e fletë,  
Vesë, shi aravët pimë, e mos lërë gjë të metë,  
Fali erë trëndelinës, manushaques, trëndafilit,  
Kalliut bukë, mizës pjesë, zogut ngrënje, zë bilbilit,  
E drurëvet epu pemë, dhe uratë bagëtisë,  
Dërgo dhëmbj' e kujdes për to në zemër të njerëzisë,  
Epi pjergulles' e veshit rush dhe vozësë fali verë,  
Mos e lërë pa të kurrë, kurrë thatë mos e lerë,  
Fali diellit flak' e zjar, dhe hënës' e yjet dritë,  
Yjtë le të vinë rrotull, dhe njerëzit të punojnë,  
Të dëfrejn e të gëzohen, si vëllezërë të shkojnë,

Tregom'u dhe Shqipëtarët udhën' e punës së mbarë  
Bashkom'i, bëmi vëllezër, edhe fjeshtë Shqipëtarë.  
Falm'i Shqipërisë ditën' e bardh' e lirisë,  
Udhën' e vëllazërisë, vahn' e gjithë mirësisë.

Nxir të vërtetënë sheshit, pas këtaj të mbretërojnë,  
Errësira të përndahet, dhe gënjeshtra të pushonjë.

# LULET E VERES



## JETA

Sa e dua gjithë jetën!  
Se atjë gjenj të vërtetën,  
Yjtë, hënën, hapësirën,  
Të mûgëtit, natën, ditën,  
Mëngjezë, djellinë, dritën,  
Mbrëmën, dh' atë errësirën

Natën, kur ësht' e qetuar,  
Edhe gjësendi s'dëgjohet;  
Qjellin kur ësht' i qëruar,  
E hapësira ndritohet,  
Ret' e zeza sterrë nd' erë.

Vapën, vjeshtën, dimrin verën,  
Retë, shinë, dhe lumenjtë,  
Gjëmim, mjèrgullë, përrrenjtë,  
Dborën, brëshërin' e erën,  
Malet, fushat edhe brigjet,  
Grykat, çukat edhe shtigjet.

Oshëtimën, pyjet, drurët,  
Shkëmbenjtë, gërxhet' e gurtë.  
Lulet, barërat që mbijnë,  
E shpesët që fluturojnë,  
Edhe këngëra këndojnë,  
E në për dega lëvrijnë.

Dhe njerin' e bagëtinë  
Dhe gjithë ç'është në jetë  
I dua si Perëndinë,  
Se ngado që këthenj sytë  
Shoh atjë Zotn' e vërtetë  
Q'është një e s'ka të dytë.

## KOH' E SHKUARE

Kam pushuar, jam qetuar,  
E rri më nj' an e derth lot,  
Me zemër të përvëluar,  
Me hulm me hidhërim plot.

Si zogu, kur bje e fryn  
Dheu mbushet me dëborë,  
Nën' strehët i mjeri hyn,  
Rri i varfër e i gjorë.

Sheh dëborënë që bije,  
Edhe zinë që ka rënë,  
Botën pa shij' e pa hije,  
Dhe s'guxon të nxier zënë.

S'sheh gjékundi lul' e fletë  
Po të ngrit' e ftohtësirë,  
Jetënë gjithë të qetë,  
Gjithësinë shkretëtirë.

Dhenë të bardhë si vezë,  
Dhe pa gjeth' e pa burbuqe,  
Zëmrëzën' e tij të zezë,  
Q'e pat si lule të kuqe.

Më s'sheh shok, as fis, as miq,  
As fëmijë, as folezë,  
Shpresëza e tij i vdiq,  
E ju përhap posí rezë.

Pa kokëzën' e fut në gjit,  
Mbyll syt e hyn në mejtim,  
Mejtohet edhe psherëtit  
Me mall shum' e mallëngjim.

Mos pandeh se fle, a dremit,  
Kur e sheh q'është qetuar,  
Dhe këllët kokëzën në gjit,  
Eshtë gjithënjë i xgjuar.

Me mëndjezet të tij thotë,  
Ah! shkoj, vate, koh' e mirë,  
Dua e mundohem kotë,  
S'e kthej dot me të pahirë.

O ju drurët' e uruar!  
Ju shoh pa lul' e pa fletë,  
Të rjepur të varfëruar,  
Edhe të that' e të shkretë!

Kështu si ju edhe unë  
Ndë jetë të shkret u thashë,  
O! sa fletë m'u-këpunë,  
Edhe ran' e më s'i pashë !

Edhe ju fusha e male  
Që nuk prishi e s'ndrohi,  
Edhe ju dale nga dale  
Më duketë po ndryshohi!

Ah! dhe ju ishit të tjerë,  
Yjt' e bukur, e ti hënë  
Kur u shikonja një herë  
Tani një zi u ka rënë.

Moj kohëz' e djelërisë  
Sa me vrap ike dhe shkove,  
Hyre në gjit të Perëndisë  
Edhe mua më harove.

Ti çdo gjëzë m'a tregove  
Të bukur e fort të mirë,  
Edhe gazë m'a shumove  
E m'epnje shumë dëshirë.

Si t'ja bënë zemr' e mjerë,  
Me kohën gënjeshtare  
Që ndrohetë kurdoherë,  
Dhe s'ngjan me të parët fare!

Duke iku na rrëmben,  
Gjithë ç'duam e ç'gjë kemi,  
Ah! e shkreta ç'na gënjen,  
Ashtu si qemë më s'jemi!

Le të bëhet urdhëri yt,  
Zot' i math e i vërtetë!  
Po pse të na mbetet në syt  
Kjo koh' e shkuar e shkretë?

## DIT' E RE

Sot është një dit' e rezë që përsëritet moti,  
Lint vera, lint ngrichtësija, lint Aliu vetë Zoti.  
Eshtë një dit' e bekuar, që rrjedh qiejshit bukurija,  
Del në shesht Zot' i vërtetë, rrëfen fytyrën e tija.  
Ngjallen të vdekurit gjithë, mal' e fusha gjelbërojnë,  
Qielli qesh, dheu gëzohet, dhe lulet lulëzojnë.  
Thonë dimëri na prishi, po s'na humbi dot për jetë,  
Erdhi kjo dit' e na gjeti, nuk' e la dhenë të shkretë.  
Qielli ësht ndrituar edhe bërë si pasqyrë,  
Dheu është zburuar, bërë fytyrë fytyrë,  
Veshur në bar e në lule edhe në gjethe në fletë,  
Bukuri e Perëndisë ka dal' e duket në jetë.  
Ujërat po burojnë, dhe venë duke kënduar,  
S'shoh gjësendi të pëlyrur, gjithë janë larë e ndruar.  
Shqerratë po blegërijnë, edhe mëmatë kërkojnë,  
Zoqtë nér gjethe lëvrijnë, dhe këndoja e fluturojnë.  
Gjithë ç'janë ngjallen, çelen, përsëriten, zburohen,  
Duhen, qeshin, rrojnë, prëhen edhe këndoja e gëzohen,  
Lint Aliu, çfaqet dita, del Zoti, vjen e vërteta,  
Mbleron dheut émbëlsira, edhe rojit po si bleta.

Në këtë gosti të Zotit gjithë bota janë ftuar,  
Të bëhen një shpirt një trup e të jenë të pajtuar.  
Eshtë dit' e dashurisë, ditë e vëllazërisë,  
Dit' e mbarë e gëzimit, dit' e bardhë e miqësisë,  
O njeri! paskëtaj kurrë fjalë të ligë mos thuash,  
Po përshëndosh gjithë ç'janë, thuaj gëzuash! gëzuash!

## PER SE?

Pse s'vjen , o dit' e mirë,  
Pse vallë nukë vjen?  
Gjer kur në errësirë?  
Mos Zoti të pëlqen?

As hidhe gardhë,  
Dhe shpejto pakë,  
O dit' e bardhë,  
Dhe jakë, jakë,  
Se të pres,  
Nukë vdes.

Jak' o dit' e uruar!  
Që lind nga perëndon,  
At; an' e ke ndrituar  
E ne pse na haron?

Dritëz' e jetës!  
Edhe e motit  
Dhe e së vërtetës,  
Dhe gaz' i Zotit,  
Ndritëna  
E xgjonna.

## ZEMERA

Fuqi' e Perëndisë  
Duketë tek do,  
Se shpirt i gjithësisë  
Po është ajo.

Ajo është gjithë ç'janë,  
Eshtë në çdo vënt  
E duket më çdo anë,  
Në trup e në mënt.

E shohëmë në qiej,  
Në shi e në rë,  
Ndë hën' e në për diej  
Esht' edhe në dhë.

Më tepër zëmrën tënë  
Atë ka për fron,  
Nuk ja dëgjon zënë,  
Zëmrën s'e dëgjon?

## DIT' E ZEZE

U gdhì një ditë, një dit' e zezë,  
Engjëllit' gjithë me lot po qanin,  
Përpara zotit shihnin një rezë,  
Rrinin tmeruar edhe zi mbanin.

Dheu qe mbuluar me një errësirë,  
E tërë bota ish egërsuar,  
Dielli e hëna ishin nxirë,  
Qielli ishte i trubulluar.

Ish bërë sterrë tej-për-tej jetë,  
E ishte nje tmer, tmer i mërzitur,  
Se kishte humbur gjith' e vërteta,  
Se gjithë bota isht' e mahnitur!

Paudhësija dhe ligësija  
Ishte bërë mbret mbi det të shkretë!  
Dhe të këqijat e padija  
Kishin zënë vënt për të vërtetë!

Ish një mynxyrë mbi njerëzinë!  
Sepse gënjeshta po prist' e qepte,  
E kish verbuar fare njerinë,  
Edh' e vërteta po mirt' e jepte.

Dritëz' e bukur e Perëndisë  
Nd' anët e rripës kishte qëndruar,  
Dhe errësira e ligësisë  
Nga të gjith' anët e kish rrethuar.

Lufton gënjeshtra me të vërtetën,  
Dhe errësira dritën luftonte,  
Që t' errësonte së gjithash jetën,  
Dhe djallëzija të mbretëronte.

Po derdhej gjaku, gjak i bekuar,  
Qjelli kish hedhur cipën e zisë.  
Përpara syve të Perëndisë.  
Engjëjtë qanin duk' e tmeruar.

Yj edhe qiej! qysh s' u-rrëzuatë?  
E si s'u bëtë cop' e thërime?  
Diell e Hënë për se qëndruatë?  
E nuk' u bëtë si zëmra ime?

O Zot i jetës shumë durove,  
Shumë durove, o zëmër-gjérë,  
Po na të gjorët na përvëlove,  
Na perzällite zëmrën e mjerë!

Njeri i ndyrë, komb' i mërzitur!  
Imam Hysenit i heth shëgjetë?  
Nukë di se ç'bën, je i mahnitur?  
E kë godit kshu? Zotn' e vërtetë?

## BESOJME

Besojmë Zotnë q'ësht' i vërtetë,  
Se gjithë ç'shohëm ësht ay vetë,  
Dhe falëtore kemi njerinë,  
Atje e gjejmë dhe Perëndinë.  
Engjellë thuhetë vetij' e mirë,  
Dhe djalli është pun' e pështirë.  
Njeriu s'vdes' po vetëm ndërrohet,  
Dhe shpirt i ndyrë kurrë s'gëzohet.  
Njerin' e bëri Zoti të lirë,  
Po duhet kurdo të bënë mirë,  
Dhe i dha mëndjen që të peshonjë,  
Dhe të paudhat t'i largësojnë.  
Të mos përflasë, të mos qërtunjë  
Të jet' i urtë, me nder të rronjë,  
Shpirti na thotë të bëjmë mirë,  
E të mos kemi kurrë dëshirë,  
Për të këqia kurrë në jetë,  
Të jemi t'urtë e të vërtetë.  
Fort lark të jemi nga marrëzija,  
E të mos rrojmë si bagëtija.  
Falje ne kemi vëllazërinë  
Dhe dashurinë e njerëzinë,

Se udh' e drejtë e Perëndisë,  
Nuk' është tjatrë, veç njerëzisë.  
Po të nderojë njeriu njerinë,  
E ka nderuar dhe Perëndinë.  
Në zëmrët tënë e gjëjmë Zonë,  
Shtëpi e tij është zëmra jonë.  
Të dil në shesh desh Zot' i vërtetë,  
Bëri njerinë dhe atje është vetë.  
Një njeri që njeh vethen e tija,  
E di se ç'është dhe Perëndija.

## UJET E BEKUARE

Ejani këtu, o shokë,  
Mblidhuni kokë për kokë,  
Pini të bëheni trokë,  
Të na shohë Perëndija!

Këtej e tutje s'gënjehem,  
Me të rreme më s'rrembehem,  
Dua të pi e të dehem,  
Ku është vera dhe rakija?

O ujhit' e bekuar!  
Nga qjelli na ke buruar?  
Zot' i math të ka dërguar  
Që të çelçë zëmrën tënë?

Lule mbijn' tek pikon tinë,  
Ti na bje batbardhësinë  
Edhe gasthin' e gaxhinë,  
Haps' i tyre t'është dhënë.

Ti neve na e bje nderë,  
Nga mendimet duke nxjerë,  
Na fluturon nëpër erë,  
E na pjek me Perëndinë!

Gjithë ç'janë na mundojnë,  
Shpirtin na e përvëlojnë,  
Na tretin e na kullojnë,  
Vetëm ti e do njerinë.

Dashurinë duke mbjellë,  
Dhe këngëtë duke pjellë,  
E gas të math duke sjellë,  
Mjerësija ne mbulohet.

Të këqijat harrohen,  
Dhe mejtimetë s'mbarohen,  
Edhe brengatë s'mejtohen,  
Njeriu qesh e gëzohet.

Jakën, shokë, të rrimë,  
Rreth druvezës' e të pimë,  
Se të nesërmen s'e dimë,  
Na arriti pleqërija.

Koha po shkon e më s'kthehet,  
Njeriu i zi gënjehet,  
Me punë të rrema merret,  
Dhe e mbulon babëzja!

Gjithë jetën nukë rrojmë,  
Shpirtinë pse t'ë mundojmë?  
Pa qasuni të këndojmë,  
Se na plasi buz' e shkretë.

Shkel e shko zëmëra ime,  
Mos bjerë në hidhërimë,  
E në breng' e në mejtime,  
Mos të gënjenjë kjo jetë.

## PERPARA KRISHTITE

Djalëth njeriu i Perëndisë  
Fytyra jote mua më tregon  
Ah! të këqijat' e njerëzisë,  
Që ka punuar edhe punon.

Se kjo fytyrë  
Eshtë pasqyrë,  
Dhe na rrëfen,  
E s'na gënjen.

Gjithë ç'ka hequr njeriu i mjerë  
Nga veth' e tinë a nga i vëllaj  
Që kanë vrarë e kanë prerë  
Pa gjyq, pa fjalë, pa pasurë faj.

Zot, ti ka vuar  
Edhe s'ke pushuar,  
Nga njeriu hoqe,  
Për të u përpoqe.

Ti u përpoqe për njerëzinë,  
Dhe dashurinë e bëre besë,  
Njeriut vure nom miqësinë,  
Që kur të lindet gjer sa të vdesë.

Për këtë fjalë  
Të qofsha falë,  
Se njerëzija  
E Perëndija.

## ZONJ' E FATIT

O moj plaka lozonjare,  
Që ndjek fatn' e njerëzisë,  
Dhe mas' e pesh s'ke fare,  
Po me shkop të marrëzisë.

Moj, po me ç'sy e me ç'faqe  
Më qasesh prap' e më çfaqe?

Të shoh që vjen po si hie  
Nga dale, si qen i qetë  
Edhe hi syvet më shtie  
T'u thaft' ajo dor' e shkretë!

Ata sy të zgurdulluar  
Ti shoh, o e mallkuar!

S"je e verbërë si thonë,  
Që s'sheh, s'di se ç'bën në jetë;  
S'je e shurdhër, pasha Zonë!  
Dëgjon posa djalli vetë,

Po je e keqe dhe shtrigë,  
E pabes' e zemër ligë!

Ti fjalëtë i ke kthyer,  
Pandaj na ke përvëluar,  
A! popo! ç'na ke gënjer!  
Njeri s'të ka trashëguar.

Dhe kur ndrin, ndrin si lugati,  
Prandaj s'të ka qëndrim fati.

Jakë, se jam dëshëruar,  
E më s'e duroj dot vrerë,  
Qesh mós rri e zemëruar,  
Makar pér një copë herë.

Qesh një herë, o leshra krënde,  
Me të qarë nuk' u dënde?

## ABAZ - ALIU

Engjëll! që m'u qase pranë  
Nga i madhi Zot,  
Pse më rrëfen Qerbelanë?  
A do të derth lot?

O moj fush' e Qerbelasë!  
Që më rri ndër sy,  
Plot me gjak t' Ali-Abasë,  
Vallë ç'ësht' ay?

C'ësht' ay që shkon kaluar,  
Ikën si veriu,  
Me dy-tri foshnja nér duar?  
Esh't' Abas-Aliu!

Shpije foshnjatë në lumë,  
Se s'durojnë dot,  
I ka marrë etja shumë,  
E qajnë me lot!

Ujët ua kanë prerë  
Janë në shtrëngim,  
Si të varfër e të mjerë,  
Në zi, në hidhërim.

Më ç'do an' i ka rrrethuar  
Kombësi faqezl,  
Komb' i lik i mallëkuar,  
Posi mizëri!

Nëpër mest të ushtrisë  
Të armikut shkon,  
Si ëngjëll i Perëndisë,  
Nd' erë fluturon!

Shigjetat si breshërimë  
I vinë ngado,  
Ay po si vetëtimë  
Ikën nëpër 'to.

Shërbëtor' e njerëzisë  
Shigjeta s'e çpon  
Edhe nder' e trimërisë  
Zoti e mburon.

Ç'ikën ay kal' i shkretë,  
Mi dhë nuk shkel  
Nga potkonjtë q'ikën shpejtë  
Zjar e flak' i del!

O moj kafshëz e uruar,  
Mos shkel për mì dhë,  
Se 'shtë gjak i bekuar,  
Ikë nëpër re!

Frat, o more lum' i shkretë!  
Mos këndo po qaj,  
Dorth lot e rënko për jetë,  
Mos qesh paskëtaj.

Se Hysejn' e Fatimesë  
Me farët të ti,  
E vranë komb' i pabesë,  
Kombi faqezë.

Abas Aliu zu' Tomorë,  
Erdhi afër nesh,  
Shqipërija s'mbet e gjorë,  
Se Zoti e desh.

Hysejni desh njerëzinë,  
Dhe për të u vra,  
Për të shpëtuar njerinë  
Ra nde Qerbela.

Hysejni'shtë dashurija  
Që fatbardhëson,  
Buron soje miqësija,  
Që na lartëson.

Jeziti 'shtë egërsirë,  
Që sjell ligësi,  
Dhe s'del soje pun' e mirë,  
Po dëm edhe zi.

Kushdo që bën mirësinë  
E ka njerëzi  
Ka besuar Alinë,  
Dhe udhën e ti.

Gënjeshtra ‘shtë Mavijeja,  
Që prish edhe sot,  
E drejta ‘shtë Fatimja,  
Dhe i madhi Zot.

E liga është Mervani  
Që nxin e shkretton,  
Djallëzija ‘shtë Syfjani,  
Që edhe sot dërmon.

Imamëtë dymbëdhjetë  
Nga der’ e Aliut,  
Hoqn’ e vuanë ndë jetë  
Për nder të njeriut.

Zotërinj! ju qofsha falë!  
Që hoqtë për nè,  
Na latë vetëm një fjalë  
Për bes’ e fë.

## FYELLI

Pa dëgjo fyellin ç'thotë  
Tregon mërgimet e shkreta,  
Qahet nga e zeza botë  
Me fjalë të vërteta.

Që kur se më kanë ndarë  
Nga shok' e nga miqësija,  
Gra e burra kanë qarë  
Nga ngashërimet e mijal!

Krahërorë e kam çpuar  
E kam bërë vrima vrima,  
Dhe kam qar' e kam rënkuar  
Me mijëra pshëritimal!

Dhe me botën e gëzuar  
Bëhem shok edhe marr pjesë,  
Dhe me njerës të helmuar  
Bëhem mik me besa-besë.

Puna si do që të bjerë  
Unë qanj me mallëngjime,  
Më çdo vënt e kur-do-herë  
Psherëtin zëmëra ime!

Gjithë botë më dëgjojnë  
Po së jashtëmi më shohin,  
Dëshirën s'm'a kuptojnë  
Zjar' e brendëshmë s'm'a njohin.

Njerëzit me mua rrinë,  
Unë qanj e mallëngjehem,  
Po dufn' e pshehtë s'm'a dinë  
Andaj kurrë s'përdëllehem.

Gjith' ata që janë ndarë  
Fyellit shokë ju bënë,  
Shkallët e tij disa farë,  
Na shkalluan mëndjen tënë.

O rrëmet i njerëzisë!  
Zër' i fyellit s'ësht' erë,  
Ky ësht; zjarr' i dashurisë  
Që i ra kallamit mjerë!

I ra qiellit e ndriti,  
I ra zëmrësë e nxehu,  
I ra verës e buçiti,  
I ra shpiritit dhe e dehu.

I dha erë trëndafilit  
I dha dritë bukurisë,  
I dha këngëtë bilbilit,  
I dha shije gjithësisë.

Ay zjar i ra në qiej,  
Edhe duke përvëluar,  
U bënë kaq yj e diej,  
Që i mba zoti ndër duar.

Nga ky zjar Zo' i vërtetë,  
Që ka ngehur gjithësinë,  
Hoth një shkëndijë në jetë,  
Dhe bëri soje njerinë.

O more zjar i bekuar!  
Unë me ty jam përzjerë,  
Pa jam tretur e kulluar,  
Po të kam shpirë, mos më lerë.

## ZEMERA

Retë kur bënенë sterrë  
Edhe era kërcëllimë,  
Dheu bënëtë skëterrë  
Edhe qjelli vetëtimë.

Zë një shi me rrëmbim shumë,  
Që zbret nga ret' e mbyt dhenë,  
Bje qiejshit si lumë,  
Pa vete të gjejë denë.

Vinë përrenjt' e rrëketë,  
Edhe uj' i turbulluar  
Vë përpara ç'gjë të jetë,  
E ç'gjen mb' udhë duke shkuar.

Ashtu dhe zëmëra ime  
Nxjerr gjëmim' e vetëtima,  
Zjar e flak' e mallëngjime,  
Derth gjaknë me psherëtima.

N'avull ngrihetë përpjetë  
Prej zëmrësë ngaha zjari,  
Edhe lotët si rrëketë  
Derdhen syvet së qari!

O miz' e mbyturë nd' ujë!  
Djell' i shpresësë në daltë,  
Do pushonjë kjo rrëmujë,  
E nuk mbetesh në baltë.

Shiu bje, dheu gjelbërohet,  
Dhe vera vjen e gjen varrë,  
Varri me fletë mbulohet  
Dhe rrëkeja shkon t'a marrë!

O det i thell' e pa anë!  
Që ke mbrënda gjithësinë,  
Nga ty dalin gjith ç'janë,  
Edhe prapë tek ty vinë.

Gjer sa të vinj' e të bjerë  
Pik' e shpirtit t'im si lumi,  
Në det të math e të gjerë  
Zëmrën t'ime s'e zë gjumi.

## TE VDEKURITE

Jakë, mejtim, jakë,  
Dua të mejtohem,  
Të rri të qetohem,  
Edhe të qanj pakë.

O moj koh' e shkuar,  
Kurdo që të kujtonj,  
Përsëri e lëndonj,  
Zëmrën e lënduar.

Vallë ku na vanë,  
Gjithë ata shokë,  
Q'i patëm mi kokë  
Ku jan', ah! ku janë?

Qysh humpnë për jetë,  
Edhe më s'i pamë?  
Ah! me tâ pse s'vamë  
Na lanë të shkretë!

Kur ishin të gjallë,  
Sa shumë i donin,  
Me një shpresë rronim!  
Si të mundim vallë?

Pa qysh t'i harrojmë?  
Zemra s'na duron  
Shpirti ndaj kërkon,  
Pa' tá si të rrojmö?

Të gjith' një qemë,  
E një zëmër kishim,  
Gjithë në shpirt ishim,  
Neve pas pse mbemë?

Të shumët' u ndanë,  
Po vallë ku vanë?  
Për jet' u mërguan?  
A po u ndryshuan?

Ndër sy po më rrinë!  
Ah! sikundër qenë,  
Më vjen sikur flenë,  
Pandeh se do vinë.

I kam ndër mënt dhe sot  
Me shtat, me fytyrë,  
E zeza mynxyrë!  
Të arthtë keq, o Zot!

Më vjen shumë herë  
Sikundër do të vinë,  
Të gjejnë shtëpinë  
Ata dhe një herë.

Të na përqafojnë,  
E diç të na thonë,  
Si kishim zakonë,  
Dhe me ne të rronjël!

Po kur më kujtohet,  
Që janë të vdekur,  
Në dhetë janë tretur,  
Zëmra më tmerohet.

I kemi mbuluar,  
Ah! në dhët të shkretë,  
Njeriu në jetë  
Lintka për të vuar!

Lint me ngashërimë,  
Rron me hidhërimë,  
Heq shumë mundime,  
Vdes me pshëritime.

Dhe gjer sa të vdesë,  
Rrihet e përpiqet,  
Kurrë nuk i hiqet  
Dhe e shkreta shpresë.

Zëmra na 'shtë vrarë,  
Dy copa 'shtë bërë  
S'e kemi të tërë,  
Se dy është çarë.

Një copë ka shkuar  
Dhe ka zënë varrë,  
Ng' ata është ndarë,  
Ndë dhë 'shtë mbuluar.

O Zot i vërtetë!  
Me sa hidhërimë  
E me ç'mallëngjime  
Rron njeriu n'jetë!

Të dashurit tanë  
Dheut krahët shtruan!  
Na e përvëluan  
Zëmrën , na e ndanë.

I kemi mbuluar  
Po shpirti që s'vdes,  
S'ka mbrëm' e mëngjes,  
Ku ka fluturuar?

Se vdekja s'e zë dot,  
Po ku vallë qëndroj?  
Në burimt të tij shkoj,  
A, tek i madhi Zot?

Si lumi që këlthet  
Me shum' oshëtimë  
E me ulërimë  
Vete prapë në det.

Munt të na bashkojnë  
Krahëhit' e vdekjes,  
Ku 'shtë vend' i pjekjes,  
Ndër 'të të na çojnë.

Këtu duhet besa,  
Mëndje pa pusho,  
Se zëmra m'a do,  
Dhe s'më pritet shpresa.

Kush dha hidhërimnë,  
Na dhuroj dhe besën,  
E të kemi shpresën,  
Kur heqim mundimnë.

U kam shumë mallë,  
Këtu më s'i shoh dot,  
Shpreh nek i madhi Zot,  
Do t'i gjenj të gjallë.

Vdekja po na thërrët!  
Sado të mënojmë,  
Varr' i ftohtë na pret,  
Atje do të shkojmë!

Si lum ajy që rron  
Njeri i vërtetë  
Në jetë të shkretë,  
E shpirtin s'e helmon.

Pa lulet q'u-thanë,  
E nuk' i shohëm sot,  
Vinë prapë mot,  
Shpirtin gjall' e kanë.

## BILBILI

Hëna plot pesë-mbëdhjetë,  
N'anët të qjellit po ndrin,  
Bota është gjith' e qetë,  
Gjësendi nuk' pepërin.

Qielli ësht' i qëruar,  
I kulluar po si ari,  
I fjetur e i qetuar,  
Syri s'nginjetë së pari.

Ka rrjedhurë si uj' ergjëndi  
Më të gjith, anët një dritë,  
Dhe prej soje gjithë vendi  
Eshtë bërë posi ditë.

Buruar një uj' i artë,  
E dhën' e ka xbukuruar,  
Majat' e malit të lartë  
Dhe gërxhet i ka zbardhuar!

Mi brigj' e mi shesh' e drurë,  
Dhe përmi det drita bije,  
E mi shkëmbënj e mi gurë,  
Dhe vise që jan' në hije.

Nata është fort e qetë,  
Dhe gjith' i ka zënë gjumi,  
Vetëm përrenjt' e rrëketë  
Ligjërojnë, edhe lumi,

Që oshëtin duke shkuar,  
Nxjer një zë plotë embëlsirë,  
Dhe ikën duke kenduar,  
Sa vete bukur' e mirë.

Veriu fryn pakë nga dale,  
Njerës, kafshë, shpes' e fletë,  
Pyje, shkëmbinj, fusha , male,  
Të gjithë janë të qetë.

Maji ka sjellë nga Zoti,  
Shumë bekim e urata,  
Eshtë xbukuruar moti,  
Dhe n' ar' është veshur nata.

Lulet kanë lulëzuar,  
Vjen një erë fort' e mirë,  
Drurëtë janë ngarkuar,  
Dhe barratë kanë mbirë.

Dhitë, kecërit e dhentë  
Edhe shqerat jan' tulitur,  
Rrinë zgjuar vetëm qëntë,  
Nëpër ledhe janë shtritur.

Se nga dëgjonet thëllëza  
Që thotë tri katër fjalë,  
Nëpër brinj' e nëpër rrëza,  
Dhe deti ka pakë valë.

Një zë tjatër tani dëgjonj!  
Që zëmrënë m'a përvëlon!  
U-doqçë, më s'munt të duronj!  
Bilbili ka zën' e këndon!

Qiej, yj e dhë, pushoni,  
Tani juve kush u dëgjon,  
Vini veshin edhe dëgjoni,  
Bilbili, bilbili këndon.

O bilbil! e di se ç'dua,  
Andaj zëri i bukur yt,  
M'a dogji shpirtinë mua,  
Edhe gjumë s'më hyn në syt!

## NJE LUL' E VISHKURE, A NJE VASHEZ' E VDEKUR

Pse mba mëri? s'e mar dot vesh,  
Përse s'më flet si një herë?  
Pse s'më shikon? pse nukë qesh?  
Ç'rri kok' unjur dhe e mjérë!

Sa e qeshur më qe dije!  
Të xbardhë gusha si kartë;  
Buza me gas ç'të kish hie!  
Më ishnje si fill' artë!

Popo! si më je shëmtuar!  
Të ka zënë varfërija,  
Më je tretur e kulluar!  
Ku fluturoj bukurija?

Të shoh të fishkurë për dhë,  
Pa shpirt, pa gjak, pa fytyrë,  
Na le, o lulëzë, na le!  
O vdekje! ç'je një mënxyrë!!

Që lott' e syvet s'i shikon,  
S'vë vesh në mallëngjime,  
Je e shurdhër, nukë dëgjon,  
Ah! je plot me hidhërimë!

Sa na dhemp e shkreta jetë!  
Ndonëse nuk e pëlqejmë,  
E pandehim të vërtetë,  
Me gjësendi s'e çkëmbejmë!

Të korr' o lulez' e gjorë,  
Të hodhe në jetet tjatër,  
E nga neve hoqe dorë!  
Më s'na ke t'ënt as të afër!

Ah! dh' atá që kanë shkuar,  
Zëmrënë zhur na e bënë,  
E kemi të përvëluar,  
Zëmra prej guri s'ka qënë.

Paskëtaj buza më s'më qesh,  
Se zëmra m'ësht' e lënduar,  
Zot' i vërtetël! të më ndjesh,  
Jam djegur e përvëluar.

Qiej! veshuni në të zi!  
Edhe ju yj më mos ndrini!  
O hënë, mos del përsëri!  
Gjithë të helmuar rrini.

Nxihu, o diell' i shkretë!  
Ditë, rrobën' e natës hidh!  
Thahu e ti po dhë për jetë,  
Ti lumë qetohu mos klith.

Të mbarohetë kjo jetë!  
Të mbretërönjë pushimi!  
Të bijemë në të qetë!  
Të gjenjë funt hidhërimi!

Rrojmë këtu me mundime,  
Me ah, e me psherëtimi,  
Me breng' e me mallëngjime,  
Me vaj e me ngashërima.

Më së fundi hyjmë në dhët,  
Edhe kurrë më s'na gjejnë!  
Bijem e humbasëm në det,  
Dhe valëtë na rrëmbejnë!

Të rrëmbyen edhe tynë,  
O lulez' e bukurisë!  
T'a shoh të venitur synë,  
Më ke ftyrën' e zisë!

Kur dhë shpirtinë ti pshonje,  
Me një psherëtimë si 'zjari,  
Gjithë ç'janë i pëvelonje  
Nukë mbetej asnje fill bari.

Vallë ku do të të shpijen,  
Në qiej përpara Zotit?  
A kërkojnë të të shtijen  
Prapë në duart të motit?

Të linç për të vdekur prapë,  
E të vdeç, që prapë të linç,  
Edhe kështu ver' e vapë,  
Gjithnjë të vec' e të vinç?

A po për jetë do të shkosh,  
Mosqënja të të mbulonjë,  
Edhe ti jetën t'a harosh,  
Dh' ajo ty të haronjë?

## GJUHA JONE

Vëllezër Shqipëtarë!  
Të prekim urtësinë,  
Të zëm' udhën, e mbarë,  
Të ngjallim Shqipërinë.

Shqipëria ka qënë,  
Edhe po do të jetë,  
Po sot në ditët tënë  
Të metë të mos ketë.

E ka nderuar Zoti  
Gjithnjë Shqipërinë,  
Ish fort mirë qëmoti,  
Do bëhet dhe tanimë.

Sa ishte trimërija  
N' atë kohët të vjetërë,  
Kish emrë Shqipëria,  
Sa s'kish nonjë vënt tjetrë.

Sa burra kordhëtarë  
Ka nxjerrë Shqipërija,  
Mê pastaj e mê parë  
Q'i shkruan Istorija.

Ajo ish koh' e zjartë,  
Dhe kish mundime tepër,  
Po sot pëndë dhe kartë  
Na duhet, nukë tjetër.

O burra Shqipëtarë,  
Të marim dituritë,  
Se s'ësht koh' e parë,  
Tani lipset dritë.

Të shkruajm gjuhën tënë,  
Kombinë t'a ndritojmë,  
Gjithë ç'ësht' e ç'ka qënë  
Nga dalëzë t'a msojmë.

Pa shihni ç'gjuh' e mirë!  
Sa shije ka e hije,  
Ç'e bukur' edh' e lirë,  
Si gjuhë Perëndije!

Shum' e bardhë kjo ditë  
Për gjithë Shqipëtarët,  
Do na sjellë një dritë,  
Që s'e kishin të parët.

Kjo dritë do na bjerë  
Të gjitha mirësitë,  
Dhe gjithë dot' i ngrerë  
Dëmet' e marrëzitë.

Si lum kush zë të mbjellë!  
Lum kush vë këtë pemë!  
Se kjo ka për të pjellë,  
S'mbulohetë me remë.

## KORÇA

O vellezër shqipëtarë!  
Gëzohi! që erdh kjo ditë,  
Kaq' e mir' e kaq' e mbarë,  
Që sjell gjithë mirësitë.

Kjo është dit' e rezë,  
Që bije vëllazérinë,  
E dëbon jetën e zezë,  
Dhe ndarjen' e marrëzinë.

T'a lusimë këtë ditë  
Që bekoj Zot' i vërtetë,  
Dh' e dërgoj me shumë dritë,  
T'i mbes emëri për jetë.

Sot e vumë gurr' e parë.  
E bekuar ësht' kjo ditë,  
Zot' i madh e pruftë mbarë,  
E na dhëntë urtësitë!

Hapu, hapu errësirë!  
Pa jakë tëhu o dritë!  
Se arriti koh' e mirë,  
U gdhi nata u bë ditë.

Sot niset një tjatrë jetë,  
Të rremenë posht' e shtije,  
Mbretëron fjal' e vërtetë  
Dhe të mirat gjith' i bije.

Zot' i math qoft' i lëvduar!  
Q'e nxjer në shesh të vërtetën,  
Se ajo sij ka buruar,  
Pae ka ndituar jetën.

Lumja ti, moj Korç' o lule  
Q'i le pas shoqet e tua,  
Si trimi në ball' u sule,  
T'a paçim për jetë hua.

Kushdo që është sot burrë,  
Dhe Shqipëtar i vërtetë,  
Emëri s'i shuhet kurrë,  
Dhe nderi i rron për jetë.

Gjuha jonë sa e mirë!  
Sa e ëmbëll! sa e gjerë!  
Sa e lehtë! sa e lirë!  
Sa e bukur! sa e vlerë!

Kjo 'shtë mëm' e mirësisë  
Që bije qytetërinë,  
Gasthin' e vëllazërisë,  
Njerëzin' e miqësinë.

S'jemi Grekër as Bullgarë,  
As gjë tjatër nukë jemi,  
Jemi vetëm Shqipëtarë,  
Një kët' emër nder' e kemi.

Ky emr' është shum' i mirë,  
Se më s'jemi të gënjer,  
Nukë jemi n'errësirë,  
E njohmë gjën' e vijer.

Perëndija na e lëntë!  
Për jetë t'a trashëgojmë,  
Edhe kurrë mos e dhëntë!  
T'a humbim a t'a harrojmë.

Të lëmë mëmënë tënë  
E të marimë një shtrigë!  
Zoti mos e pastë thënë!  
Pun' e keq' e shum' e ligë.

O! sa qenë të gënjer,  
Ata që vuan pér botë,  
Turp të math kanë rrëfyer  
Punuanë fare kotë.

Pa mejtoni, o të gjorë,  
Efialtin, Pafsaninë,  
Që u bënë trathëtorë,  
Dh' e gjenë më Perëndinë.

Nga gjithë ç'kemi kënduar,  
Për të njohur vetëhenë,  
Kaqë gjë kemi mësuar:  
Të nderojmë mëmëdhenë.

Se njerzit gjithë vdesin,  
Pojeta s'mbetet e shkretë,  
Gjuha, Mëmëdheu mbesin,  
Të patundura për jetë.

Me zëmërë të gëzuar,  
Dhe me gjithë shpirt uroni!  
Zotërinjt' e Zotëruar!  
Gjithë përnjëherë thoni:

Rroft' e qoftë Shqipërija!  
Dhe kombi e gjuha jonë  
Lulëzoftë diturija!  
Edhe ndihmës paçim Zonë!

Edhe Sulltani të mirë,  
Mbrteit t'math q' e kemi atë  
Dhe ka për neve mëshirë  
E përpinqet dit' e natë.

Zoti jet' e dit' të dhëntë  
Dhe qëllimet ja mbaroftë!  
Me nder për mi front e lëntë!  
Dhe gjithnjë e gëzoftë!

## PERENDIJA

Ç'sheh ësht Zot' i vërtetë,  
Ç'dëgjon është zër' i tija,  
Gjithë ç'ka e s'ka në jetë  
Eshtë vetë Perëndija.

Mos shiko valëtë p'anë  
Mos të gënjenjë rrëneti,  
Të tëra një burim kanë,  
Gjithë ngrihen prej një deti.

Në det të math e të gjerë,  
Çdo valë që të sheh syri  
Atje është det' i tërë,  
Po valëtë mirë qyri.

Kur t'a zësh gjënë të bërë,  
Esht' ashtu me të vërtetë,  
Po t'a vësh re gjat' e gjerë,  
Esh't' ajy bëresi vetë.

Dhe kush flet, edhe ç'gjë flitet,  
Ç'duket e s'duket në jetë,  
Dhe kush sheh, dh' ajo që shihet  
Zot' i vërtet' është vetë.

Se e tërë gjithësija,  
Që nuk' i gjëndetë fundi,  
Eshtë vetë Perëndija,  
Për atë s'ka vënt gjékundi.

Eshtë në shesht Perëndija,  
I verbëri s'munt t'a shohë,  
Ajo është gjithësija,  
I dituri mund t'a njoħë.

Pe një lulezë kur shohim,  
Dhe të vëmë re një fletë,  
Me diturí, t'a njoħim,  
Q'atje 'shtë Zot' i vërtetë.

Eshtë në shesht Perëndija,  
Sicili do munt t'a njoħë,  
Po s'e mbuloj e padija,  
Njerí tekdo munt t'a shohë.

Kush do t'a shohë të tërë,  
Të shohë mirë njerinë,  
Vethen' e tij re të vërë,  
Atje gjen Perëndinë.

Dhe Parajsi dhe Skëterra,  
Dhe ëngjëlli edhe djalli,  
Edhe gjithë ç'ka të tjera,  
Janë mbrënda tek i gjalli.

Ajy që ka mirësinë  
Ka Perëndin' e të mirat,  
Edhe kush ka djallëzinë,  
Ka djallë e ligësirat.

Më çdo anë e kërkova,  
Thashë, ku 'shtë Perëndija?  
Po më pastaj e mësova,  
Qënka ndaj mej' e s'e dija!

Kërkonja gjetkë t'a gjeje  
Zotn' e math e të vërtetë,  
Ajy qënëkej ndaj meje,  
E paskësha unë vetë!

Me fjal' e me agjërimë  
Nuk' e gjen dot Perëndinë,  
As me kreshm' e me kungime,  
Si punojn' ata që s'dinë.

Trajstën' e ke plot me bukë  
Edhe hiqesh si i mjerë,  
Dhe ke zën' e thua nukë  
E lipën derë më derë!

Eshtë ndaj teje i gjallë,  
Ti e kërkon nëpër gurë,  
Në të rrem e në përrallë  
Andaj nuk' e gjen dot kurrë.

Pa s'vdes kurrë Perëndija  
Po kush vdes në jetë vallë?  
Gjë s'vdes, sepse gjithësija  
Eshtë gjithnjë e gjallë.

Qeshë diellë, ishnja hënë,  
U bësh' uj' e balt' e erë,  
Ylli e zok e dash kam qënë  
Pa edhe njeri shumë herë.

Sa det i math e i gjerë!  
Edhe sa mijëra valë,  
Si-cili atje do të bjerë  
Prapë soje do të dalë.

Mëjëra shpirtëra ngrihen,  
Bijen mijëra të tjera,  
Vjen dimëri , lulet pshihen,  
I nxjer prapë në shesht vera.

Nj' është, po ka shumë gjyrë  
Duket sikur s'ka të ngjarë,  
E sheh fytyrë fytyrë  
Po 'shtë i njëjt' e i pandarë.

Ajy është trëndafili  
Edhe gjëmb' i trëndafilit,  
Ajy është dhe bilbili,  
Ajy dhe zër' i bilbilit.

Mos shiko ç'rrobë ka veshur  
Eshtë mbrënda vet' i qetë,  
Syr' i t'urtit e sheh çveshur  
Veç ati s'ka gjë në jetë.

Zoti është gjithësija  
Ay është gjithë ç'janë,  
Po kush njeh vethen' e tija  
S'e kërkon më tjetër anë.

Dhe qelqeja u-hollua  
Dhe vena pa u përzjenë,  
S'ka ven' është qelqe thua  
A s'ka qelqe, është venë!

Unë ndaj teje një pikë?  
O det i gjër' e pa anë!  
Të hynj brënda! më vjen frikë!  
Po s'hiqem dot dhe më nj'anë.

Të kisha zën' e bilbilit  
Gjithnjë do të këndonja  
Bukurin' e trëndafilit,  
Dhe kurrë të mos pushonja!

Po ti vetë je, o bilbil,  
Ti je edhe dashurija,  
Ti je edhe trëndafili  
Edhe bukuri e tija.

Ti je ç'është jet' e tërë  
Ti je vetë gjithësija,  
Ti vetë njeri je bërë  
More fytyrën e tija!

Oh! det i madh, i pa-anë,  
Në një stamnë qysh ka hyrë?  
Ay q'është gjithë ç'janë!  
U mblodh tok me një fytyrë?

Më çdo anë që shikova,  
Pashë mirë që je vetë,  
Të gjeta tek të kërkova  
Zot' i madh e i vërtetë!

Prej trupi shpirt është bërë,  
Edhe shpirti trup në jetë,  
Eshtë bërë një i tërë  
Gjithë ç'është është vetë!

Paskëtaj, o shokë, kurrë  
Mos kërkoni Perëndinë,  
Nëpër mur' e nëpër gurë,  
Po shihni mirë njerinë!

Zëmr' e njeriut në jetë  
Eshtë vënt' i Perëndisë,  
Esht' atje Zot' i vërtetë  
Det' i madh i gjithësisë.

Ay është gjithësija  
Edhe udh' e Perëndisë,  
Eshtë vetëm njerëzija  
Q'i duhetë njerëzisë.

Merr' dorën e diturisë  
Pa ajo do të nxjerë  
Gjer te fron' i Perëndisë,  
Ndaj soje do të të shpjerë.

Esht' e vërtetë kjo punë  
Mos qëndroni n'errësirët,  
Se këtë s'e gjeta unë  
E kanë thënë të Mirët.

## SHPREH

Kam shumë shpresë  
Te Perëndija,  
Që të mos jesë  
Kshu Shqipërija,  
Po të ndritohet  
Të lulëzohet.

Pa vjen një ditë  
Që të na sjellë  
Të madhe dritë  
P'ajo të pjellë:  
Qytetërinë,  
Fatbardhësinë.

Vëllazërija  
Edhe bashkimi  
E njerëzija  
Eshtë shpëtimi,  
Lum kush t'arrinjë!  
Pa do të vinjë.

Që Shqipërija  
Do të ndritohet,  
Dhe ligësija  
Do të mërgohet.  
Jak' e vërtetë!  
Pse rri e qetë?

Për Shqipërinë  
Ditët e mira  
Paskëtaj vinë  
Shkoj errësira,  
Lum kush të rronjë,  
T'a shohë zonjë!

Se Shqipëtari  
E gjuh' e tija  
Venë së mbari  
Dhe Shqipërija,  
Lum kush t'a shohë  
Për pak kohë.

Pa dituritë  
Dhe mbrothësija  
E mirësitë  
Dhe njerëzija,  
Do të burojnë  
Nukë mënojnë.

## TRADHETORET

Shokë! kemi në mest tënë  
Shum' armiq' e tradhëtorë!  
Popo! mos u qoftë thënë!  
Veç që s'kanë gjë në dorë!

Haruanë Mëmëdhenë!  
Dh' e lanë kombinë tënë!  
E një tjetërë na gjenë!  
Popo! mos u qoftë dhënë!

Lanë Zonjën' e lëvduar!  
E zunë një kurvë shtrigë!  
Të ndyr' e të mallkuar!  
Të fëlliqur' e të ligë!

Lanë Mëmënë të çveshur!  
Dhe mundohenë për botë!  
Pa dhe bota duke qeshur  
U thotë, mundohi kotë!

Qysh u bënë Efialtë!  
E nuk e njohin të mirën,  
Uthullën pandehin mjaltë  
Edhe dritë errësirën!

Buk' e Mëmëdheut i zëntë!  
Tradhetorët' e pabesë,  
Dhe Zoti dërmën u-dhëntë,  
Kurrë mos paçinë pjesë!

Miqt' armiq i kanë bërë!  
Armikëtë miq i zunë!  
Qysh janë fyell të tërë!  
Ç'është kjo e madhe punë!

Fajn' e madh kur do t'a njohim  
Njerëzit e mallkuar?  
Dritënë pse nuk' e shohin?  
Apo janë të verbuar?

Janë së gjithash të marrë!  
Dhe të liq me të vërtetë,  
Mëmëdheut bëjnë varrë,  
Po do të bienë vetë.

Se mbretëron e vërteta,  
S'del kurrë gënjeshtr' e shkretë,  
T' ish ashtu, qe prishurjeta,  
S'kish mbetur gjë e vërtetë.

Ata turpinë fitojnë  
Nder' e tyre posht' e hedhin,  
Dhe armikëtë gjëzojnë  
E në errësirët bredhin.

Nuk' është kurrë harruar  
E mira dh' e lig' e shkretë,  
Të gjitha janë paguar,  
S'ka mbetur gjë në jetë.

Lerini, pa do t'a gjejnë  
Të vërtetën do t'a njojin,  
Se tani s'e dinë ç'bëjnë,  
Jan' të verbër' e nuk shohin.

O! popo, ç'turp kanë marrë!  
Janë bërë tradhëtorë!  
Dhe s'janë më Shqipëtarë  
Se nga kombi hoqnë dorë!

Me të huajnë u-bënë!  
Me armikn' e Shqipërisë!  
S'duanë gjuhënë tënë  
Armikëtë e Perëndisë!

Ndjej' o Zot se nukë dinë  
Se ç'bëjnë, janë mahnitur,  
Rrahin të prishin shtëpinë!  
Pun'e lig' edh' e mërzitur.

Të gjorët janë në gjumë!  
Të vërtetënë s'e dinë,  
Do të mundohenë shumë,  
Pastaj mëntë do t'u vinë.

Vëllazërin' e harrojnë  
Dhe kombin e mëmëdhenë  
Dhe armikëtë dëgjojnë!  
Edhe s'dinë se ku venë!

Hiqni dorë, hinqni dorë!  
Mblidhni mënt' e turpërohi,  
Mos u-bëni tradhëtorë  
Se pastaj do të pendohi.

# BUKURIJA

1

Do tē këndonj Bukurinë  
E tē lëvdonj Perëndinë,  
Perëndin' e bukurisë,  
Q'i dha shijë gjithësisë!

Perëndija bukuroshe!  
Ty tē falem e tē lutem  
Më vjen në gjí tē tē futem  
O zonja përkëdheloshe!  
Që më je si mbretëreshë,  
Të keqen o pëllumbeshë.

2

Zot i vërtetë!  
Ke mbledhur dritën,  
Diellin, dritën,  
Ndë gjithë jetë,  
Edh' e ke bërë  
Gush' e krahruar,  
Faqez' e ballë,  
Dhe pulp' e llërë,  
Sy e qepallë,  
Dhe këmb' e duar!

Në fytyrët tënde gjeta Bukurinë,  
 Si ajo që gjeti në malt Perëndinë.  
 Lulezët e Majit sa janë të mira!  
 Po përpara teje m'erdhë të pështira.

Kur shoh faqezët' e tua,  
 Ç'vjeft' i mbetet trëndafilit,  
 Zëri yt shpirt më jep mua,  
 Nuk' i le shijë bilbilit.

Edhe yjt' e hëna si të shëmëtuar  
 M'u duknë, kur pashë atë syn' e shkruar,  
 Purtek' e florinjtë! shigjet' e ergjëntë!  
 Zëmrënë m'a dogje, m'i përndave mëntë!

Do të vdisnja me shumë gas,  
 Të paskësha pakë shpresë,  
 Se do të thuash ti më pas,  
 Vdiq, për mua, pastë ndjesë.

Kudo është Bukurija,  
 Në qiej, në dhë, në hënë,  
 Në diell, në shënje, në yje,  
 Ndër lule, ndër drurë, ndër pyje,

Çdo vënt që të ketë zënë,  
Atje çfaqet Perëndija,  
Po këtu është e tërë,  
Dhe ajo tin është bërë!

5

Pashë pjeshkëtë ndër fletë,  
Pa m'u-mejtua gjiri yt,  
Edhe më mbenë përpjetë  
Në zëmrët, në shpirtit, në syt!  
Jaseminë kur e pashë,  
Q'ish i bardhë si dëborë,  
Pse më ndjek zëmrën i thashë,  
E më ngjan më atë dorë?  
Dhe në mejtim të madh rashë,  
Më ra në det mëndja, m'u mbyt,  
Më la vetëm e të shkretë,  
Edhe të mjer' e të gjorë!

6

Qiriri meje ka mësuar  
Të digjet të përvëlohet,  
Edhe duke përvëluar,  
Të qeshnjë e të gëzohet,  
Të bënëtë zjar e flakë,  
Të tretet pak' e nga pakë.

Ti e mësove trëndafilë  
Të çelet, të lulëzohet,  
Të qeshnj' e të zbulurohet,  
T'a përvëlonjë bilbilë,  
E t'a bënëjë të pëlcasë,  
Një fjalë të mos i flasë,  
Dhe nga kjo t'i vinjë mirë,  
Të zbulurohet më mirë,  
E të mos ketë mëshirë,  
Po t'a lerë dhe pa gjumë.

7

Bërrhama jote o hurma!  
Më rrëfen bukur e mirë;  
Zëmr' e buz-ëmblësë, më tha,  
Esh't' e fort' e p'amblësirë.  
Po fjalënë s'ja besova,  
Nuk' ësh't' e vërtetë, thashë,  
Tani holl e kupëtova,  
Se me syt' e mi e pashë.

8

O more shtat i florinjtë!  
Bukurija teje buron,  
Edhe të rrjedh nga pëqinjtë,  
Gjithë jetën e zbuluron.

Më ecën me shumë shijë,  
Dhe si thëllëza më vështron,  
Edhe më hedh një shkëndijë,  
Dhe zëmrënë m'a përvëlon.

Të keqen e këmbës sáte,  
Të ju-bëfsha ati syri,  
E leshravet si tërtërë,  
E qepallës si gjilpërë,  
Që në zëmërë më hyri.  
Ç'pate, që më vrave, ç'pate?

Nga qepallatë jam qarë,  
Po të vërtetën' e gjeta,  
Vetullat më paskan vrarë,  
Më vrou hargu, jo shigjeta.

9

Zëmra jote në krahrort tënt  
Eshtë hekur brënda n'ergjënt;  
Dhe në linj' ajy krahruar,  
Si ndë dhë gur' i paçmuar.  
Dielli zënë me rezë,  
Vera në qelqe të zezë,  
Shpirti brenda nér qivure,  
Zot i madh nér katrë mure!

Do tē shtrihem  
 Tē venitem,  
 Si kandili kur s'ka vaj,  
 Balt' e pluhur  
 Do tē bëhem,  
 Tē më shkelnjë këmb' e saj;  
 E tē prehem  
 Duke puthur  
 Atë këmbë pasandaj.  
 As më thua,  
 Ç'ke më thua?  
 Pse tē dua paskam faj?

Pse heq unë  
 Hidhërimë,  
 A në vdekça ti mos qaj  
 Vdekja ime,  
 S'të prish punë,  
 Haj, e zeza jetë, haj!  
 O veri! pa hiq i thua  
 Sorkadhësë qafë-gjatë:  
 Më ka thënë pyllë mua,  
 S'mblidhem dot as dit' as natë!

Pyete vallë përse,  
Pastaj jak' e më rrëfë.  
Bukuroshe! sy-mëshqerë!  
Shikomë një herë mua,  
Trëndafil' i kuq me erë!  
E di vallë sa të dua?  
E mora vdekjen në sy,  
Do të vdes, të vdes për ty.

## 12

...Mos i hap leshratë n'erë  
Të m'arratiç mëndjen t'ime,  
Mos më shiko dhe një herë,  
Se m'u bë zëmra thërrime.  
Si thëllëx' e bukur mos shko  
Mos vështro si pëllumbeshë,  
Shpirtinë mos m'a përvëlo,  
Mos u tunt si mbretëreshë.  
Me qepallatë si shtijë  
Mos më vra mos më plagos,  
Me vështrim po si shkëndijë  
Mos më vdis e mos më sos.

## 13

E pashë dije tek shkonte,  
Soje ndritte gjithëjeta,  
Pa hoth syt' e më shikonte,

Duke kthyer si shigjeta!  
Posa pashë Bukurinë,  
Zemrën' e varfrë m'a piku,  
Ndjeva në të dashurinë,  
Që më erdh, dhe më s'më iku.  
Pse s'ka fjalë të dëftenjë  
Dashurin' e Bukurinë,  
Nuk' e them dot atë ndjenjë,  
Nuk' e them dot Perëndinë!  
Mos u mundo kot,  
Nukë thuhet dot.

## 14

M'iku me vrap djalëria  
E më la mbi dhe të shkretë,  
Më erdh shtriga pleqërija  
Pshehtazi, si qen' i qetë.  
O popo! ç'më gjet, o shokë,  
Do të qanj me thes në kokë,  
O ditët e djalërisë,  
Që kishit shumë gëzime  
Ratë në det t'arratisë,  
Më lartë në hidhërimë!  
Tani jetënë ç'e dua,  
Më s'ësht' e shkreta për mua,  
Ti o bukuroshja ime !  
Të ritë m'a paç për jetë,  
Kurrë mos pafsh hidhërimë!

Të dashtë Zot' i vërtetë!  
Syri yt mos u-venittë.

## 15

Vera vate, shkoj,  
Bilibili pushoj,  
Lulet u-thanë!  
Dimëri u-qas,  
Dëborë vjen pas,  
Fletëtë rënë.  
Gjësendi më s'mbet  
Thua për mi dhet,  
Shpestë pushuan!  
Zëmra ime zjen,  
E ty më s'të gjen  
Pa heq e vuan.

## 16

Erdh e na gjet  
Vera mi dhet,  
Dhe këtë herë  
Për shumë vjet  
E me shëndet,  
Na gjeç, o verë!  
Sa më pëlqen,  
E ç'më dëfren

Luleja mua!  
Ç'mirë më vjen  
Se shëmbëllen

Faqet e tua.  
del të të shoh,  
Oh! oh! oh! oh!

O sy mëshqerë  
Dua t'a ngroh,  
Se po m'u ftoh

Zëmr' e mjerë.  
Syri m'u vesh,  
Po del në shesh,

Malli m'u shtua,  
Shih, mos më lesh!  
Popo! kur qesh,

Ah, sa të dual!

## VARFĒRIJA

1

Ju të pasur, kur rrini  
Rreth zjarit me gëzime  
Qeshni, hani e pini,  
Xaviti me dëfrime.

Kërceni e këndoni,  
Dhe çeli e gëzohi,  
Bëni gaxhi e loni  
Edhe prëhi e ngrohi.

Ju vjen së largu afshi,  
Ndëallonet të gjerë,  
Shtruarë pej mëndafshi  
Mbushur me gjë të vlerë.

Nga ari, nga ergjëndi,  
Nga floriri, nga drita  
Llapëtin gjithë vëndi,  
Tfaqet natënë dita.

Zonjat bukuroshe  
Veshur, rrobat' e arta,  
Vashatë vogëloshe,  
Të bardha posi karta.

Djemthit e përkëdhelur  
Të lartë e të ndruar  
Me zëmërë të çelur,  
Me buzë të gëzuar.

Vinë rrëth e kërcejnë,  
Dhe qeshin e këndojnë,  
Lozinë e dëfrejnë,  
Kohën me gaz e shkojnë.

Dhe juve duke parë  
Me sy fatbardhësinë,  
S'ju vjen fare të qarë  
Vallë për varfërinë?

E dini q'është jashtë  
Një plak' e dobëtuar:  
E përgynjyr, e lashtë,  
E mjer' ë dëshëruar,

E fishkur' edh' e thatë,  
E thunjur e kärcure,  
E urët dit' e natë,  
Dergjetë nér qivure!

Një plak' q'i vdiq fëmija,  
Edhe mbet e helmuar,  
Se ju shkretua shtëpija,  
Mbet si kandil' i shuar!

Një foshnj' e varfëruar,  
Pa mëmëz' e pa átë,  
E gjor' e dobëtuar!  
E ligur e e thatë!

Gjithë këta të mjerë  
Në të këqija rrojnë,  
Vin' e lipin më derë,  
Një kafshítë kërkojnë!

E kur vjen të kërkonjë,  
Brengën s'munt t'a rrëfenjë,  
E rreh të na dëfrenjë!

Sa 'shtë turp për njerinë,  
Ku shkojm' e s'kthejmë synë!  
S'dëgjojmë Perëndinë?  
S'është vëllathi ynë?

Oh! epni, ju që kini,  
Kush i ndih varfërisë,  
Ay q'ep, po e dini,  
Q'i huan Perëndisë.

T'apim, se yjen një ditë  
Q'e lemë këtë jetë,  
Dhe gjën' e bagëtitë,  
Vemi në të vërtetë,

Përpara Perëndisë,  
Që do të na gjykonjë,  
Urát e varfërisë  
Arrin të na shpëtonjë.

Ajo or' e borinjtë,  
Që ligjëron e bije,  
Rreth t'i mplaknjë të rinjtë,  
Buzë varrit na shpije!

Epni t'u falnjë Zoti  
Juve gjithë të mirat,  
E të mos muntrnjë moti  
T'ju sjellë të pahirat.

Mba unaza në dorë  
Pa një farë nevoje!  
Zonjë! shumë të gjorë  
Vdesën për bukë ngoje!

Ep t'apë Perëndija  
Të gjitha mirësitë,  
Të të kenë fëmija  
Shëndet e jet' e ditë.

Zot i madh, i vërtetë!  
E gjithë ju të Mirët!  
Mos e lini për jetë  
Njerinë n'errësirët.

## 2

Sa jemi Shqipëtarë,  
Kemi gjithë një besë,  
Jemi gjithë një farë,  
Dhe rrojmë me një shpresë,  
S'jemi kurrë të ndarë.

Bes' është Perëndija  
Për gjithë Shqipëtarët.  
Edhe vëllazërija,  
Urtësija, të mbarët,  
Fë është njerëzija.

Më çdo vënt që të jemi,  
Mëmëdhen' e kujtojmë,  
Edhe kudo të vemi,  
Kombinë s'e harrojmë,  
Vëllazërin' e kemi.

Si do që të na ndajnë,  
Ne jemi të bashkuar,  
S'mundinë të na çajnë,  
Zoti na ka uruar,  
Pa në kurt dot s'na mbajnë.

Në ka pasur në jetë,  
Trima shumë të ndjerë,  
E burra të vërtetë,  
Kombi yn' i ka nxjerë,  
At' e di Zoti vetë.

## **Permbajtja**

### **BAGETI E BUJQESIJA**

Bageti e Bujqesija..... 3

### **LULET E VERES**

Jeta..... 27

Koh' e shkuar..... 29

Dit' e re..... 33

Per se..... 35

Zemera..... 36

Dit' e zeze..... 37

Besojme..... 39

Perpara Krishtit ..... 44

Zonj' e fatit..... 46

Abaz- Aliu..... 48

Fyelli..... 52

Zemera ..... 55

Te vdekurit ..... 57

Bilbili ..... 63

Nje lul'e vishkure, a nje vashez' e vdekure....66

Gjuha jone..... 70

Korça.....	73
Perendija.....	77
Shpreh.....	84
Tradhetoret.....	86
Bukurija.....	90
Verferija.....	100

Formati 61x86/16 Tirazhi 1000 kopje

Shtypur ne shtypshkronjen "Mesonjetorja"  
Tirane, 1998



*Gjuha joneë sa e mirë!  
Sa e ëmbël! sa e gjereë!  
Sa e lehtë! sa e lirë!  
Sa e bukur! sa e vlerë!*